



VENDIM

Nr. 60, Datë 03.06.2013

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS OST SH.A DHE FURNIZUESVE TË
KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, pikës 4.13 gërma “A” pika 3, pikës 7 gërma “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.06.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe marrëveshjen tip te transmetimit të energjisë elektrike, midis OST sh.a dhe furnizuesve te kualifikuar,

Konstatoi se:

- Subjektet e kesaj kontrate, OST sh.a dhe cdo Furnizues i Kualifikuar, janë subjekte të liçensuara nga ERE;
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, te ndryshuar;
- Modeli i Tregut vendos ERE-n ne cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Miratimin e draft marrëveshjes tip për Sherbimin e Transmetimin midis OST dhe Furnizuesve të Kualifikuar.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI